



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPKI</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>06-02/4270/22</u>
Nr. llog. Broj stranica <u>2</u>	Data Datum <u>27.10.2022</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 20.10.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-2784/22, për zyrtarin e lartë z. Driton Hetemi, Anëtar i Bordit Drejtues të Radiotelevizionit të Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka pranuar shkresën (DPKI-06-2784/22) nga z. Driton Hetemi, përmes së cilës ka kërkuar sqarim për situatë të mundshme të konflikti të interesit, respektivisht, nëse ushtrimi i funksionit të anëtarit të Bordit në RTK dhe Kryeshefit Ekzekutiv në Swinto¹ në të njëjtën kohë, paraqet ndonjë konflikt të interesit. Lidhur me këtë, Agjencia e ka hapur dhe trajtuar rastin sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Pas shqyrtimit të kërkesës së z. Hetemi, si dhe bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia ka kontaktuar me të njëjtin dhe e ka njoftuar atë se gjatë ushtrimit

¹ Kompani Private

të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksionin menaxhues (Kryeshefit Ekzekutiv) në biznes privat, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Zyrtari i lartë, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.


Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-4210/22) me dokumentet përcjellëse, në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë, ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni menaxhues në biznesin privat.

Me veprimet e ndërmarra nga z. Hetemi, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, në lidhje me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

